



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242413
Datë: 04.07.2024
Numri i dokumentit: 05901532

Ac.nr.1183/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. e S. “E.” SH.A. me seli në Prishtinë, Rr. “T. S.”, nr..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit nga V. A., kundër të paditurit S. Q., adresa: B. i M., Komuna Fushë Kosovë, përfaqësuar nga I. S., avokat në Prishtinë, objekti i kontestit rimbursim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3705/2017, datë 09.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit S. Q. nga Fushë Kosova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3705/2017, datë 09.11.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.831/2015, datë 04.07.2021, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses K. e S. “E.”, me seli në Prishtinë, rruga “T. S.”, nr., kundër të paditurit S. Q., nga fshati B. i M., Komuna e Fushë Kosovës, si e bazuar dhe DETYROHET i padituri që paditëses t’ia paguaj shumën prej 2,122 €, në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.12.2013, në Prishtinë. II. DETYROHET i padituri që paditëses, shumën e gjykuar sikurse në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 29.12.2017 (data e ushtrimit të padisë në gjykatë), e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto ti përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i padituri, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurit, lënda të kthehet në rigjykim, apo të refuzohet kërkesëpadia si e pa bazuar.

Pala paditëse nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datën 29.12.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, duke kërkuar të detyrohet i padituri që paditëses t'i kompensoj shumën prej 2,100€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 28.12.2013 në Prishtinë, me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Meqenëse i padituri ka vozitur pa patentë shofer, i njëjti ka humbur mbulesën siguruese dhe detyrohet të paguaj në emër të regresimit të dëmit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka arsyetuar fillimisht rrjedhën e aksidentit përmes raporti të policës së datës 28.12.2013, duke vërtetuar se i padituri në kohën e shkakimit të aksidentit nuk kishte patent shofer aksidenti kishe ndodhur ndërmjet paditësit dhe personit të dëmtuar i cili ishte në cilësi të këmbësorit. Përmes Ekspertizën së Komunikacionit të punuar nga eksperti F. S., e datës 08.02.2014, gjykata vërtetoi se aksidenti ka ndodhur me lëshimet e të paditurit i cili në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti nuk ka qenë i kujdesshëm sa duhet gjatë lëvizjes prapa në rrugë dhe i njëjti nuk ka vepruar konform Ligjit mbi Sigurinë në Komunikacion. Nga Marrëveshja Jashtëgjyqësore me numër 0222/14/01, e datës 30.10.2014, e lidhur mes paditëses dhe të dëmtuarit I. R., gjykata konstaton se palët me ujdë rregullojnë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me rastin e dëmit material dhe jo material për lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 28.12.2013, përgjegjëse e të cilit ishte tani i padituri, ku palët me këtë marrëveshje ishin dakorduar që paditësja të dëmtuarit për lëndimet trupore të pësuar në këtë aksident t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,622 €. Nga urdhër pagesa – transferi bankar i datës 09.06.2014, paditësja ka kryer pagesën për të dëmtuarin I. R., detyrimin sipas marrëveshjes për paradhënie me nr. 022/14/01, të datës 06.06.2014, në shumë prej 500 €, ndërsa nga urdhër pagesa – transferi bankar i datës 07.11.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja e ka përmbushur detyrimin sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore me numër 0222/14/01, të datës 30.10.2014, në shumë prej 1,622 €, duke e paguar gjithsejtë shumën në lartësi prej 2,122 €.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Përfaqësuesi i palës së paditur ka ngritur pretendim ankimor për a i përket shkeljes nga neni 182.2 pika (k), porse të njëjtën pikë nuk e ka argumentuar, sido që të jetë, në vlerësim të këtij pretendimi për të cilin gjykata kujdeset zyrtarisht, gjykata ankimore gjeti se nuk ka të meta në përfaqësim të palëve, apo se subjektet që paraqiten si palë, nuk mund të jenë palë në procedurë. Gjithashtu pretendimi ankimor nga neni 182.2 pika (o) që ndërlidhet në tejkalimin e kërkesëpadisë, rezultoi i pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë ka vepruar brenda kufijve të përcaktuar nga pala paditëse.

Nuk qëndron pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata përmes provave të siguruara nga pala paditëse në këtë rast Raporti Policor mbi aksidentin datë 28.12.2013, ka vërtetuar faktin e ndodhjes së aksidentit të trafikut, po ashtu fakti se nuk i padituri nuk kishte patentë shofer në kohën e shkakimit të aksidentit. Më tej është bërë administrimi i ekspertizës së komunikacionit e datës 08.02.2014, përmes së cilës është dhënë vlerësimi se përgjegjës për ndodhjen e aksidentit ka qenë i padituri, në këtë mënyrë, fajësia e të padituri ka rezultuar e qartë nga këto prova. Për sa i përket lëndimit të pësuar nga pala e dëmtar, është vërtetuar përmes raporteve mjekësore dhe konsultave. Është vërtetuar se për shumën që paraqitet si objekt i kontestit, paditësja me të dëmtuarin kishte lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore datë 30.10.2014 për kompensim dëmi në lartësi prej 1622€, si dhe marrëveshja për paradhënie në shumë prej 500€. Po ashtu në shkresa të lëndës gjenden edhe urdhërtransferet për këto shuma. Nga analizimi i thënieve në ankesë, për pjesën që ka të bëjë me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Lidhur me pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase nuk është vërtetuar shkalla e lëndimit apo baza e kërkesëpadisë, lidhur me këtë gjykata kishte administruar raportet mjekësore që kishe ofruar si prova paditësja, më pas kallëzimin penal si dhe ekspertizën e komunikacionit. Paditësja kishte hartuar vendimet për kompensim, ashtu që tanimë lind e drejta e regresit.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale. Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Kjo gjykatë gjen se në kuptim të nenit 14 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia përcaktohet se: *I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit.* Kurse par. 3 i të njëjtit nen përcakton: *Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.* Rrjedhimisht paditësja ka të drejtë të kërkojë regres nga shkaktari i dëmit i cili nuk kishte patentë shofer.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1183/2022, datë 04.07.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli